



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e I-rë (një - mandati VIII) -Inauguruese, e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 17 korrik 2026

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10:20

Kjo mbledhje është thirr nga Kryesuesi i Kuvendit z.Isak Shabani, cili edhe e kryesoi deri në zgjedhjen e Kryesuesit të Komitetit, ku pas zgjedhjes së z.Xhafer Ademit i njëjti në cilësinë e Kryesuesit të zgjedhur të Komitetit e mori detyrën dhe e kryesoi këtë mbledhje.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët e këtij Komiteti dhe atë:

z.Ardi Hasani; znj.Vlora Jashanica; znj.Blerta Azemi-Berisha; z.Besim Latifi; z.Demokrat Hodolli; z.Rrhaim Sejdiu; znj.Vlorjana Avdiu; z.Xhafer Ademi; znj.Dorontina Tahiri; z.Muhamet Sadiku; znj.Sevdije Mustafa.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm tjerë ishin: z.Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK; z.Driton Shabani nga Stacioni Policor në Podujevë; z.Bekim Karaxhia, z.Benjamin Murgatroyd dhe Mefail Mustafa përfaqësues të OSBE-së; dhe z.Gabor Vitkoci përfaqësues i KFOR.

Rendi i ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, theksoi, në bazë të dispozitave përkatëse të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës si dhe Rregullores së punës së Kuvendit e kam thirrë këtë mbledhje inauguruese / konstituive të Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Rendin e ditës besoj të gjithë e keni marrë me kohë dhe keni parë se pika e parë është zgjedhja e Kryesuesit/es së Komitetit për Komunitete si dhe pika e dytë është ngritja e Grupit punues për hartimin e planit të punës së Komitetit për pjesën e mbetur të vitit 2026.

Ne si Kuvend i Komunës i kemi përfunduar të gjitha procedurat dhe keni parë që është shkaktuar një vonesë sa i përket këtij Komiteti, jo për fajin tonë por për shkak të procedurave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, kështu që në momentin që kemi pranuar konfirmimin e ligjshmërisë së vendimit të themelimit të këtij Komiteti.

Tani më vije mirë që prezent janë të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete në këtë mbledhje të cilët i përshëndes dhe ju jam mirënjohës, po ashtu përshëndes edhe mysafirët prezent që janë nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, nga Policia e Kosovës, OSBE, KFOR dhe të tjerë, kështu që besoj pajtohemi të vazhdojmë me punë sipas rendit të ditës, andaj nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën rreth rendit të ditës unë e hedh në votim këtë rend të ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

Njëzëri me 11 vota Për nga anëtarët/et e Komitetit për Komunitete, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Zgjedhja e Kryesuesit/es të Komitetit për Komunitete

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, theksoi, për ata që për herë të parë janë pjesë e këtij Komiteti unë do të doja që fillimisht të lexoj disa prej detyrave të Komitetit për Komunitete për çka janë përgjegjës:

-Janë përgjegjës për promovimin dhe afirmimin e të drejtave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim, dhe bënë rekomandime Kuvendit të komunës.

-Shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për të siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve të respektohen plotësisht.

-Për të shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor.

-Sigurimin dhe mbrojtjen adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda Komunës.

Pra ky Komitet ka edhe detyra dhe përgjegjësi tjera por mbi të gjitha këto ishin prej atyre më të rëndësishme që janë të theksuara edhe në Udhëzimin Administrativ nr.02/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera.

Para se të fillojmë me procedurat e zgjedhjes së kryesuesit/ses së Komitetit, ju kërkoj falje paraprakisht se më duhet ta përshejtoj paksë procedurën sepse pas pak jam një takim me Kolegjin e Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave të Kosovës, dhe më duhet të shkoj por paraprakisht do të propozoja që për pikën e parë të rendit të ditës ta kryesoj unë nga cilësia e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës dhe pastaj me t'u zgjedh kryesuesi/ja, kryesimi i vazhdimit të mbledhjes kalon tek ai/ajo.

z.Liman Zeqiri, shëf i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i'u dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje, theksoi, nga përvoja ime rreth 22 vjeçare që udhëheqë procese që ndërlidhen me Komitetin për Komunitete nga cilësia e Udhëheqësit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, unë do të sugjeroja që në kuadër të rendit të ditës të përfshihet edhe një pikë shtesë, pika Të Ndryshme.

Po ashtu, sërish nga përvoja e them se normale krahas Kryesuesit/ses së Komitetit duhet të jetë edhe zëvendës kryesuesi/sja e këtij Komiteti, arsyeja e kësaj Është shumë e thjeshtë sepse mund të ndodh të jetë Kryesuesi i Komitetit që për shkaqe objektive apo subjektive të mos mund ta kryesoj ndonjë mbledhje apo rastësisht të mos mund ta thërras ndonjë mbledhje ose sa i përket caktimit të rendit të ditës për mbledhje të cilin ligjërisht e cakton Kryesuesi i Komitetit por nëse mungon kryesuesi atëherë është mirë të jetë edhe zëvendës kryesuesi që të procedoj me këto çështje, i cili mund të jetë edhe nga radhët e anëtarëve të Kuvendit që janë pjesë e këtij Komiteti, prandaj zgjedhja e zëvendës kryesuesit/ses nuk do të prishte asgjë punë, përndryshe vetëm do ta pasuronte Komitetin për Komunitete.

Pra kjo është arsyeja që unë e theksova sepse në vazhdimësi unë kam punë me këtë Komitet qoftë në koordinim, bashkëpunim dhe në konsultim për caktimin e rendit të ditës qoftë për çështje tjera sipas nevojave të tyre.

Pra kemi edhe pikën Të Ndryshme e cila çdo herë duhet të jetë pikë e rendit të ditës në mbledhjen e Komitetit për Komunitete sepse ka anëtar të cilët kanë kërkesa, ankesa apo ndonjë çështje për ta ngritur në atë pikë sepse realisht ky proces është vonuar paksë dhe ka çështje të cilat janë grumbulluar në këtë aspekt, prandaj unë do të propozoja të përfshihen edhe këto dy çështje që i ceka në kuadër të rendit të ditës në qoftë se edhe të tjerët janë të pajtimit.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, theksoi, ju falënderoj zotëri Zeqiri, mirëpo rendi i ditës veçse u miratua pak më parë dhe tani proceduralisht nuk mund ta kthejmë, aq më shumë në këtë mbledhje konstituive dhe të bëjmë shkelje procedurale dhe po ashtu që të mos e ngarkojmë më shumë.

Po ashtu ju njoftoj, edhe pse jam në dijeni se keni përvojë në këtë punë sepse jeni qe shumë vite këtu në këtë funksion që je, mirëpo mbi të gjitha ju njoftoj se Komitetit për Politikë dhe Financa nuk ka zëvendës kryesues, por edhe në këtë Udhëzimin Administrativ që e ceka pak më parë thuhet që; në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i Komitetit, do të thotë kjo çështje është e precizuar, pra nëse rastësisht mungon kryesuesi/ja mbledhjen do të thotë e udhëheqë anëtari/ja më i vjetër i këtij Komiteti.

Prandaj meqë rendi i ditës u miratua pak më parë, konsideroj se është mirë të vazhdohet me procedura sipas asaj që u miratua, përndryshe nëse kanë diçka shumë për ngutë apo të domosdoshme për ta trajtuar ky Komitet, mund të thirre mbledhja tjera dhe t'i paraqet çështjet që konsiderohet se janë të nevojshme për tu trajtuar.

z.Liman Zeqiri, shef i -ZKKK, theksoi, unë në fjalën time e ceka se nga praktike e mëparshme ka qenë i zgjedhur edhe zëvendës kryesuesi/ja, përndryshe anëtari/ja më i vjetër mund të jetë zëvendësues me automatizëm dhe kjo është obligative si dhe mund të ndërmerr veprime, mirëpo atëherë do të mund të zgjidhej anëtari ose anëtarja më e vjetër si zëvendës kryesues/e ose të paktën të dihet kush është në mënyrë që në rast të mungesës së kryesuesit ai ose ajo të merre rolin e Kryesuesit/es. Pra kjo është procedurë dhe si proces do ta ndihmonte punën e këtij Komiteti, përndryshe unë vetëm e sqarove praktikën e mëparshme qysh ka qenë, dhe për të mirë të këtij Komiteti për Komunitete.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, theksoi, sa për sqarim edhe njëherë po i kthehem kësaj teme dhe ju informoj se as Kuvendi i Komunës nuk ka zëvendës kryesues por është e rregulluar që në rast të mungesës për çfarëdo arsye të kryesuesit, anëtari/ja më i vjetër i thërret dhe udhëheqë mbledhjet si ndërmerr edhe veprime tjera në emër të Kryesuesit të Kuvendit, kështu që edhe te Komitetet është e njëjta gjë, besoj që u sqarua edhe kjo çështje, dhe tani do të kaloja në pikën e parë të rendit të ditës që është zgjedhja e Kryesuesit/es të Komitetit për Komunitete, urdhëroni mund ta merrni fjalën për paraqitjen e propozimeve për kryesues / kryesuese të Komitetit për Komunitete, pra kush ju mendoni që duhet të jetë në këtë funksion i cili i'u takon komuniteteve jo shumicë si dhe duke paraqitur një CV (jetëshkrim) të shkurtër të anëtarit/es së propozuar, urdhëroni fjala për ju.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, vetëm sa për qëllim të ndihmës në procedura të kësaj çështje sepse nuk do të doja të kalonte kjo temë si blic dhe të zgjedhet kryesuesi/ja e këtij Komiteti. Çdo herë nga praktika e kaluar që kemi pasë sa i përket Komitetit për Komunitete të Komunës së Podujevës ku drejtuesi ose kryesuesi i Komitetit de-fakto dhe de-jure ngarkohet me një barrë shtesë në këtë Komitet për qendrat ose lagjet ku jetojnë komunitetet jo shumicë në territorin e Komunës së Podujevës sepse këtu tek ne kryesisht jetojnë bashkërisht nëpër lagje, fshatra dhe pjesë të tjera, komunitetit shumicë dhe jo shumicë dhe jemi shembull si Komunë në gjithë Kosovën në këto procese madje tani edhe sa i përket avancimit të të drejtave të tyre.

Në bazë të shënimeve që kam, e që jam i përgatitur për këtë mbledhje sepse mbaj shumë shënime, të dhënat janë këto; në fshatin Orllan janë 7 familje të komunitetit Ashkali me 44 anëtar gjithsej, po dua ta potencoj këtë pse është e arsyeshme të theksohet kjo, është që kryesuesi/ja mundësisht të jetë prej një qendre më të madhe ku jetojnë komunitete jo shumicë, në fshatin Batllavë janë 13 familje të komunitetit jo shumicë Ashkali me 63 anëtar gjithsej, në fshatin Sfeçël janë 3 familje me 13 anëtarë, në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr."Ali Ajeti" që është lagja ku ka më së shumti familje dhe anëtar e që janë 71 familje 388 anëtarë të komunitetit Ashkali dhe 9 familje të komunitetit Rom me 67 anëtarë si dhe komuniteti Agjiptas janë 2 familje me 11 anëtarë gjithsej, pra gjithsejtë janë 163 shtëpi dhe familje në këto lagje e që normale janë 935 anëtarë ose banorë.

Pastaj kemi lagjen në rr."Skënderbeu" dhe rr."Xhafer Meta" siç njihet Podujeva-2, në të cilën jetojnë 51 familje të komunitetit Ashkali me 318 anëtarë ose banorë.

Andaj në bazë të këtyre të dhënave dhe procedurave përkatëse, unë mund të konstatoj se gjithsejtë Komuna e Podujevës ka 163 shtëpi ose familje me 935 anëtarë ose banorë të komuniteteve jo shumicë Ashkali, Rom dhe Egjiptas. Pra në qoftë se duam që gjithmonë të përballemi me problemet, hallet dhe dertet e tyre sa im përket infrastrukturës, arsimit, shëndetësisë dhe të gjitha problematikat tjera për të cilat çdo herë kemi biseduar dhe kemi kontaktuar dhe analizuar, prandaj është mirë që kryesuesi/ja të jetë nga aty ku është përfaqësimi më i madh i familjeve të komuniteteve jo shumicë, e them këtë sepse ka pas raste kur është zgjedh dikush nga periferia por që pastaj nuk ka mund t'i kryej detyrat e veta, këtë e them edhe nga aspekti i Zyrës që unë e përfaqësoj, pa dashtë të interferoj në këtë sepse këta e kanë të drejtën e tyre për ta zgjedhë atë që mendojnë se është bashkëpunëtori/ja më i mirë në funksion të avancimin të të drejtave të komuniteteve jo shumicë.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, theksoi, mund të them se ajo që e potencoj parafolës rreth asaj se kush është mitë të jetë kryesues ose kryesuese e këtij Komiteti ishte më shumë në formë të rekomandimit, përndryshe secili anëtar i këtij Komiteti ka të drejtë të propozoj, të shpreh bindjet veta dhe të sugjeroj anëtar/e nga komuniteti jo shumicë për kryesues/e të Komitetit për Komunitete, andaj lus që tani të fillohet me dhënien e propozimeve.

z.Muhamet Sadiku, theksoi, unë në këtë Komitet jam përfaqësues i komunitetit Rom. Për kryesues të këtij Komiteti propozoj z.Xhafer Ademi, i cili ka një përvojë të gjatë sa i përket aktiviteteve të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës si dhe për faktin që ka qenë Kryesues i Komitetit për Komunitete në Komunën e Podujevës për më shumë se 1 mandat.

z.Ardi Hasani, theksoi, personalisht unë por edhe në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së e falënderojmë z.Xhafer Ademin për kontributin që ka dhënë për komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës, mirëpo në këtë rast mendoj që do të ishte mirë të zgjedhej një grua kryesuese e këtij Komiteti, kjo edhe për faktin që Kryesues i Kuvendit dhe i Komitetit për Politikë dhe Financa është mashkull dhe për të krijuar paksa barazi gjinore në këtë aspekt duke zgjedhur një grua kryesuese të Komitetit për Komunitete.

Sa i përket CV-ve të të propozuarve, unë kam biseduar në Zyrën Ligjore dhe me z.Liman Zeqirin shef i ZKKK-së në Komunën e Podujevës dhe asnjë CV të anëtarëve të komuniteteve jo shumicë nuk e gjetëm te këto dy instanca, kështu që si do qoftë, po kalojmë te propozimi.

Grupi i LVV-së propozon znj.Vlorjana Avdiu për kryesuese të Komitetit për Komunitete dhe përtej këtij propozimi tonin mendoj që është mirë që të gjithë së bashku të punojmë në këtë drejtim që gjithçka të shkojë mbarë, si dhe ky propozim të mos konsiderohet si diskriminim ose si propozim partiak.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, theksoi, urdhëroni nëse ka propozime tjera, nëse jo atëherë mund të konstatojmë e kemi dy propozime për kryesues/e të Komitetit për Komunitete, andaj pa humbur kohë vazhdojmë me procedurat tjera duke i hedh një nga një sipas radhës. Fillimisht e hedh në votim propozimin e z.Muhamet Sadiku që kryesues i këtij Komiteti të zgjedhet z.Xhafer Ademi anëtar i këtij Komiteti nga radhët e komunitetit jo shumicë Ashkali.

Pas votimit u konstatua se nga 11 anëtar/e të Komitetit, 5 vota ishin Për, të tjerët nuk morën pjesë në votim, që z.Xhafer Ademi të zgjedhet Kryesues i Komitetit për Komunitete.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, theksoi, tani e hedh në votim propozimin e z.Ardi Hasani që znj.Vlorjana Avdiu anëtare e këtij Komitetit nga radhët e komunitetit Ashkali.

Pas votimit u konstatua se nga 11 anëtar/e të Komitetit, 4 vota ishin Për, të tjerët nuk morën pjesë në votim, që znj.Vlorjana Avdiu të zgjedhet Kryesuese e Komitetit për Komunitete.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, theksoi, atëherë në bazë të këtyre rezultateve të këtij votimi njëri kishte 5 vota Për, tjera 4 vota Për, kurse përbërja e këtij Komiteti është prej 11 anëtarëve e që duhet të jenë 6 vota Për, për t'u zgjedh Kryesues/e, andaj në këtë situatë procesi i zgjedhjes së kryesuesit/es mund të kthehet në fillim me propozime tjera nëse keni.

znj.Sevdiye Mustafa, theksoi, unë së bashku me kolegen time znj.Vlorjana Avdiu nuk votuam fare në këtë proces, mirëpo në konsultim e sipër tani vendosëm që të votojmë për z.Xhafer Ademin ish kryesuesin që ka qenë deri tani i këtij Komiteti në mandatin e kaluar dhe me përvojë. Prandaj nëse nuk ka propozime tjera në këtë proces, edhe ne do votojmë për propozimin e parë.

z.Besim Latifi, theksoi, sa i përket zgjedhjes së kryesuesit/es së këtij Komiteti besoj që më e rrugës do të ishte që propozimet të vijnë nga vetë anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe në këtë aspekt ne e mbështesim secilin propozim që vije jashtë asamblesë komunale për arsye se ata e dinë më së mirë cilët janë përfaqësuesit më të mirë apo të nevojshëm për ta se sa ne si asambleistë të cilët normal mund të japim kontributin tonë, mirëpo këta si komunitet jo shumicë e dinë më së mirë se kush mund t'i përfaqësoj më së miri dhe vet e zgjedhin kryesuesin/en e këtij Komiteti.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, theksoi, atëherë për ta mos ndërprerë këtë mbledhje si dhe për t'iu shmangur thirrjes së një mbledhje tjetër nga fillimi, unë konstatoj se nuk ka propozime tjera të reja por mbeten sërish në procedurë dy propozimet e dhëna paraprakisht, si dhe për faktin që pas votimit pati deklarime tjera që tani janë të gatshëm të votojnë, a jeni të pajtimit që të mbeten të propozuar këta dy kandidat por edhe me mundësinë e paraqitjes së propozimeve të reja nëse ka.

Pra, meqë nuk ka propozime tjera, vazhdojmë edhe njëherë me përsëritjen e votimit për dy kandidatët e propozuar paraprakisht për kryesues/e të Komitetit për Komunitet; z.Xhafer Ademi dhe znj.Vlorjana Avdiu, urdhëroni votojmë sipas radhës.

Pas votimit të dytë, u konstatua se nga 11 anëtar/e të Komitetit, 8 vota ishin Për, të tjerët nuk morën pjesë në votim, që z.Xhafer Ademi të zgjedhet Kryesues i Komitetit për Komunitete

Pas votimit të dytë u konstatua se nga 11 anëtar/e të Komitetit, 3 vota ishin Për, të tjerët nuk morën pjesë në votim, që znj.Vlorjana Avdiu të zgjedhet Kryesuese e Komitetit për Komunitete

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, theksoi, bazuar në rezultatet e këtij votimi, konstatoj që z.Xhafer Ademi anëtar i Komitetit për komunitete nga radhët e komunitetit jo shumicë Ashkali, zgjedhet Kryesues i Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Podujevës në mandatin e VIII, të cilit i dëshiroj punë të mbarë dhe në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës shpreh gatishmëri të plotë për bashkëpunim dhe për çdo gjë që i drejtohet apo që ka të bëjë me Kuvendin e Komunës, pra jeni të mirëpritur edhe në zyrë për çdo çështje dhe për çdo kërkesë që është në kompetencë të Kuvendit të Komunës.

nga tani thërras kryesuesin e posa zgjedhur të këtij Komiteti të vije këtu dhe ta merr dhe vazhdon kryesimin e kësaj mbledhje sipas rendit të ditës.

Pasi që tani z.Xhafer Ademi e merr kryesimin e kësaj mbledhje dhe të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë nga ky funksion, unë duke ju kërkuar falje që më duhet të shkoj në angazhimet që

kam, konkretisht më duhet të shkoj në Prishtinë për takim në Kolegjin e Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave të Kosovës. Edhe njëherë urime dhe nga tani jeni kryesues i Komitetit për Komunitete, duke ju falënderuar ju uroj punë të mbarë.

Konstatim / Konkluzion:

Komititeti për Komunitete i themelua me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0031716/26 datë 28.05.2026, në mbledhjen e I-rë inauguruese të mbajtur më 17 korrik 2026, nga numri prej 11 anëtarëve të Komitetit për Komunitete, pas diskutimeve dhe dhënies së propozimeve sa i përket zgjedhjes së Kryesuesit/es të Komitetit, dhe përfundimit të procesit të votimit, me Konkluzion u konstatua se me 8 vota Për, z.Xhafer Ademi përfaqësues i Komitetit jo shumicë Ashkali, zgjedhet Kryesues i Komitetit për Komunitete në kuadër të Kuvendit të Komunës së Podujevës, dhe atë me mandat të njëjtë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në legjislaturën e VIII, përveç nëse nuk vendoset ndryshe nga vetë Komiteti për Komunitete apo ndonjë akt tjetër.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i zgjedhur i Komitetit për Komunitete, fjalë rasti, theksoi, ju falënderoj të gjithëve, falënderoj të pranishmit, me theks Policinë e Kosovës, OSBE-në dhe KFOR, gjithashtu edhe asambleistët e Kuvendit të komunës prezent këtu që janë edhe anëtar të këtij Komiteti, e posaçërisht një përshëndetje e veçantë shkon për z.Liman Zeqirin i cili na ka ndihmuar gjithherë dhe është i gatshëm gjithherë të na ndihmoj në punët tona qoftë si Komitet për Komunitete qoftë si komunitete jo shumicë që jetojmë në Komunën e Podujevës.

Për ata që nuk më njohin, unë jam Xhafer Ademi nga radhët e komunitetit jo shumicë Ashkali, kam qenë edhe në mandatin e kaluar kryesues i këtij Komiteti e që mund të konstatoj se kemi qenë një Komiteti me punë, aktivitete dhe bashkëpunim shumë të mirë përgjatë mandatit, por nuk kanë munguar edhe sukseset, prandaj besoj që edhe në këtë mandat do të kalojmë shumë mirë, edhe pse paksa jemi me vonesë sa i përket themelimit dhe konstituimit të këtij Komiteti ashtu siç e ceku edhe z.Liman Zeqiri, mirëpo besoj dhe do të angazhohem që të gjitha punët dhe aktivitetet që na presin do t'i kryejmë sa më shpejt të jetë e mundur.

Ju falënderoj të gjithëve për votimin që më besuat që unë të zgjedhem Kryesues i Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Podujevës në këtë mandat 4 vjeçar.

Tani mund të vazhdojmë me punë sipas rendit të ditës.

2. Ngritja e Grupit punues për hartimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete për pjesën e mbetur të vitit 2026

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit për Komunitete, theksoi, rreth kësaj pike mendoj që pasi të ngritet ky Grup punues, për arsye që kemi humbur kohë dhe tani duhet të kemi angazhime dhe zyrtari për punë të Kuvendit dhe Komiteteve besoj mund të na ndihmoj me dokumentacion duke na e përgatitur modelin e Planit të punës sikurse që ka qenë viteve të kaluara, dhe të hënën të takohemi si Grup punues dhe të përgatitim një draft fillestar të Planit të punës së Komitetit për pjesën e mbetur të këtij viti sa na ka mbet, pastaj të thërrasim mbledhjen e radhës dhe ta shqyrtojmë dhe miratojmë Planin.

Sipas praktikës së kaluar, kryesuesi i Komitetit çdo herë ka qenë edhe kryesues i Grupit si bartës i procesit, pastaj mund të propozoni anëtarët tjerë dhe numrin e përbërjes, dhe ta formojmë atë, propozim i imi është të shkojmë me 5 anëtar dhe atë duke u përfaqësuar të gjitha komunitetet dhe përfaqësimi i subjekteve të Kuvendit, urdhëroni kush dëshiron fjalën.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, në të kaluarën Komiteti për Komunitete ka qenë i përbërë prej 9 anëtarëve, tani përbëhet prej 11 anëtarëve, normale që nuk prish punë asgjë që përbërja e këtij Grupi punues të jetë prej 5 ose 7 anëtarëve, vetëm të jetë tek, për shkak të votimit.

Pra, ashtu siç u potencua, Kryesuesi i Komitetit është mirë të jetë edhe bartës i këtij Grupi, pastaj përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë dhe anëtarët nga subjektet politike përfaqësuese në Kuvendit e Komunës.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit për Komunitete, theksoi, atëherë po vazhdojmë në këtë format, një nga komuniteti Ashkali e që nëse pajtoheni të jem unë, përfaqësuesit e komuniteteve Rom që është z.Muhamet Sadiku dhe nga komuniteti Egjiptas që është znj.Sevdije Mustafa, si dhe dy anëtar/e të subjekteve politike të Kuvendit që janë edhe anëtar/e në këtë Komitet që mund t'i propozojnë, urdhëroni.

znj.Vlora Jashanica, theksoi, nga Grupi i LVV-së e propozojmë z.Ardi Hasani për anëtar në këtë Grup punues.

z.Besim Latifi, theksoi, nga Grupi i LDK-së propozojmë znj.Blerta Berisha për anëtare në këtë Grup punues.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit për Komunitete, atëherë meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, unë e hedh në votim përbërjen e Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për pjesën e mbetur të vitit 2026, sipas përbërjes dhe propozimeve të paraqitura.

Konstatohet se Njëzëri me 11 vota Për, ngritët Grupi punues për hartimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete për pjesën e mbetur të vitit 2026, në këtë përbërje:

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit dhe i këtij Grupi.

z.Muhamet Sadiku, anëtar nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Rom

znj.Sevdije Mustafa, anëtare nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Egjiptas

z.Ardi Hasani, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës

znj.Blerta Azemi Berisha, anëtare nga përbërja e Kuvendit të Komunës

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe njëherë jua rikujtoj që të hënën nga ora 10:00, anëtarët e këtij Grupi punues i cili posa u ngrit, të takohemi në këtë sallë me qëllim të përgatitjes së dokumentit të Planit të punës sipas modelit të mëparshëm të cilin besoj që zyrtari i Zyrës ligjore dhe për punë të Kuvendit do të na e dërgoj ndërkohë.

Nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, duke u falënderuar për pjesëmarrje dhe për angazhimin e juaj, e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0041838/25
Podujevë, 17 korrik 2026**

**Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani**

**Kryesuesi i zgjedhur e Komitetit
Xhafer Ademi**